



Komisioni për Riinvestim në Komunitet dhe Mbylljen e Ishullit Rikers: Seancë dëgjimore publike

I themeluar sipas legjislacioni vendor në 2019, Komisioni për Riinvestim në Komunitet dhe Mbylljen e Ishullit Rikers (Commission on Community Reinvestment and the Closure of Rikers Island) është i përkushtuar ndaj procesit të riinvestimit të drejtë të kursimeve nga mbyllja e Rikers për komunitetet e përfshira në sistemin e drejtësisë dhe të prekura nga sistemi i drejtësisë.

Seanca dëgjimore njeh rëndësinë e angazhimit të komunitetit dhe të zërat, opinioneve dhe pjesëmarrjes së individëve me përvoja të jetuara, si dhe të bashkëpunimit me përfaqësues nga organizatat komunitare, ofruesit e shërbimeve dhe agjencitë qeveritare.

KUR DHE KU DO TË MBAHET SEANCA DËGJIMORE?



Të premten, 30 maj 2025



9 AM - 11 AM

Seanca dëgjimore do të mbahet në distancë nëpërmjet platformës "Zoom"

Personat do të thirren sipas radhës së regjistrimit dhe ju mund të flisni për maksimumi tre (3) minuta.

Qëllimi i seancës dëgjimore është t'ju japë mundësinë të ndani komentet tuaja se si qyteti mund të investojë në lagjet dhe komunitetet e prekura nga sistemi i drejtësisë. Roli i stafit është të dëgjojë dhe të mbajë shënim komentet tuaja.

SI MUND TË MARR PJESË?

Çdokush mund të marrë pjesë në seancën dëgjimore online ose me telefon si më poshtë:

Mund të aplikoni për të folur në seancën dëgjimore publike duke u regjistruar në datën **27 maj 2025** ose më përpara.

ONLINE:

<https://forms.office.com/g/w1FTZFQvx7>



DUKE TELEFONUAR:

929-221-7220

DUKE DËRGUAR EMAIL:

Reinvestment@dss.nyc.gov

- **Online (video dhe audio)**

Vizitoni <https://www.zoomgov.com/j/1603120242>

Ose vizitoni Zoom.us. Klikoni "Join a Meeting"
(Bashkoju një takim).

Jepni **Meeting ID (ID-ja e takimit): 160 312 0242**
(nuk kërkohet kodkalim).

- **Me telefon (vetëm audio)**

Telefononi numrin **646-828-7666**. Kur t'ju kërkohet, jepni
Meeting ID (ID-ja e takimit): 160 312 0242
(nuk kërkohet kodkalim).

Nëse keni nevojë për ndihmë për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, si për shembull me një përkthyes ose akomodim të arsyeshëm për një aftësi të kufizuar, duhet të na informoni para datës **27 maj 2025**.

Na telefononi në numrin **929-221-7220** ose na dërgoni email në **Reinvestment@dss.nyc.gov**.

Publikut do t'i vihet në dispozicion një transkript i seancës dëgjimore në faqen e internetit të HRA-së
<https://www.nyc.gov/site/hra/about/about-hra.page>,
një javë pas seancës në fjalë.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e Komisionit për Riinvestim
<https://www.nyc.gov/site/hra/about/about-hra.page>.

Komentet me shkrim mund të dërgohen në adresën
Reinvestment@dss.nyc.gov